




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**

**Nr. 02-060/01-0072093/5-1, dt. 08.08.2022**

**Mitrovicë**



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 73, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Statutit të Komunës; nenit 8, paragrafi 3, të Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2016 Për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna; në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005769/22-7 dt. 31.01.2022 Për themelimin e komiteteve konsultative, pasi shqyrtoj Raportin e Panelit përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative Nr. 02-060/01-0060095/22-10 dt. 08.07.2022; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 08.08.2022; sjell këtë:

**VENDIM**

**Për emërimin e anëtares së Komitetit konsultativ për Shërbime Publike, Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit**

1. Znj. **Teuta Abazi** EMËROHET anëtare e Komitetit konsultativ për Shërbime Publike, Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.
3. E emëruara sipas pikës 1 të këtij vendimi do të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësit e parapara me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2016 Për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna.
4. Mandati i anëtares së emëruar është 4 (katër) vjeçar.
5. Anëtarët e komiteteve konsultative për punën e tyre kompensohen nga buxheti i Komunës. Shuma e kompensimit është 50€ dhe është e njëjtë me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës dhe nuk mund të paguhet për më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi është përgjegjës Kryetari i Komunës dhe Kryesuesja e Kuvendit të Komunës.
7. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

**Mitrovicë**

**Dorëzohet:**

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës  
Anëtarëve të emëruar

